



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1035 prot

Himarë, më 24.02.2022

V E N D I M

Nr. 11 ,datë 24.02 .2022

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES PREJ 210 M2 PËR
NDËRTIMIN E STACIONIT "VODAFON"SH.A PËR VËNIE ANTENE SI DHE LINJE
ELEKTRIKE NË TERRITORIN E BASHKISË HIMARË**

Bazuar në ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin nr. 57/2020 "Për Pyjet", ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar , Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit dhe ish-komunave/bashkive në pronësi të bashkive"

Këshilli Bashkiak Himarë pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë;

V E N D O S I:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të miratimit të dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 210 m2 të ndodhur në Kuç, Njësia Administrative Hor-Vranisht, Himarë me qëllim vendosjen e Stacionit të Antenës "VODAFON" SH.A.
2. Të shpreh dakortësinë që së bashku me ndërtimin e Stacionit të Antenës "VODAFON"SH.A të vendoset linja elektrike TM me gjatësi 1927 ml dhe hapjen e rrugës 575 ml.
3. Drejtoria e Financës, Planifikimit të Buxhetit dhe Integritimit Europian në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të bëj llogaritjet përkatëse për vjeljen e tarifave sipas akteve ligjore në fuqi.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55, pika 6.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elena Memushaj



KRYETAR I KËSHILLIT
Dhimitër Kapaj